R E P U B L I K A S H Q I P Ë R I S Ë

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___.2022

OPINION

MBI

KANDIDATIN QË KA APLIKUAR PËR T'U KOMANDUAR

NË MINISTRINË E DREJTËSISË

I. Hyrje

1. Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 86, shkronja "d", të Ligjit nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", në nenet 53, 54, 57 dhe 58 të Ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", si dhe në kërkesën e Ministrisë së Drejtësisë, me vendimin nr. 425, datë 14.10.2022 ka vendosur: Shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Ministrinë e Drejtësisë për pozicionin "Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit". Afati i paraqitjes së kërkesave për komandim është përcaktuar **data 31 Tetor**.
2. Brenda afatit të caktuar për paraqitjen e kërkesave për komandim, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor ka paraqitur kërkesë vetëm një kërkesë.
3. Me shkresën nr. 5616, datë 26.10.2022, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor është protokolluar kërkesa e gjyqtarit {…}, i cili ushtron funksionin e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës. Z. {…} ka shfaqur vullnetin për t'u komanduar në Ministrinë e Drejtësisë për pozicionin "Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit".
4. Në vendimin nr. 425, datë 14.10.2022 të Këshillit, konkretisht në Kreun II të tij, është përcaktuar edhe procedura që do të ndiqet nga Këshilli.
5. "*Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, do të vlerësojë* ***plotësimin e kushteve të komandimit nga kandidatët që do të aplikojnë.*** *Ky vlerësim do bëhet brenda dy javëve pas përfundimit të afatit të aplikimit. Komisioni përgatit një projekt-opinion për çdo kandidat, i cili shqyrtohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor jo më vonë se një javë pas njoftimit të Kryetarit të Këshillit për përgatitjen e tyre. Opinionet e miratuara nga Këshilli publikohen në faqen zyrtare të tij. Këshilli mund të vendos përjashtimin nga komandimi të kandidatit kur komandimi nuk është në përputhje me interesat e lartë të gjykatës ku ai ushtron funksionin ose kur verifikohet që kandidati nuk plotëson ndonjë prej kushteve të tjera të komandimit.*"
6. Sipas parashikimit të bërë **në pikën 7 të Kreut II**, Këshilli i Lartë Gjyqësor i përcjell menjëherë Ministrisë së Drejtësisë aplikimet e kandidatëve të cilët plotësojnë kushtet për komandimin në pozicionin e "Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit".

7. **Në pikën 8 të këtij Kreu**, parashikohet se, **brenda dy javëve nga marrja e kërkesës, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendos për komandimin,** në pozicionin respektiv të kandidatit të përzgjedhur nga Ministria e Drejtësisë.

II. Vlerësimi i Komisionit

8. Në respektim të procedurës që duhet të ndiqet sipas vendimit nr. 425, datë 14.10.2022 të Këshillit **në fazën e parë**, brenda dy javëve pas përfundimit të afatit të aplikimit, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës përgatit një projekt-opinion për çdo kandidat dhe vlerëson nëse komandimi nuk është në përputhje me interesat e lartë të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin.
9. Në këto rrethana Komisoni i Zhvillimit të Karrierës harton Projekt-opinionin për kandidatin {…}. Sa më sipër, në përgatitjen e këtij opinioni për këtë kandidat, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, verifikon për këtë kandidat, ekzistencën ose jo të ndonjë prej kritereve ndaluese si dhe vlerëson cenimin apo dëmtimin e funksionalitetit të gjykatës ku ushtron detyrën gjyqtari që ka paraqitur kërkesën për komandim.

i. Në lidhje me kriteret ndaluese të komandimit.

10. Kushtet e komandimit përcaktohen në nenin 53, të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Po ashtu ato janë përcaktuar në pikën 3, Kreu II të Vendimit të Këshillit nr. 425, datë 14.10.2022. Konkretisht, në këtë pikë të këtij vendimi përcaktohet se: "Kushtet e komandimit janë:
a) Komandimi nuk duhet të bjerë ndesh me interesat e lartë të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin e gjyqtarit;
b) Kandidati nuk duhet të jetë në një pozicion me mandat të kufizuar;
c) Kandidati nuk duhet të jetë i komanduar;
ç) Kandidati, që ka qenë i komanduar më parë, duhet të ketë shërbyer jo më pak se pesë vjet si gjyqtar pas përfundimit të periudhës së mëparshme të komandimit;
d) Kandidati nuk duhet të ketë masë disiplinore në fuqi".
Lidhur me kushtet e komandimit sipas shkronjave "b", "c", "ç" dhe "d", të pikës 3, të vendimit të sipërcituar të Këshillit, sipas informacionit të marrë, më datë 15.11.2022, nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, mbështetur në të dhënat e dosjes personale të kandidatit, rezulton se:

11. Z. {…} ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit "Luarasi" në datë 03.07.2013, ka përfunduar studimet Master i Shkencave, në profilin "E drejtë penale" në Universitetin "Luarasi" në datë 16.07.2015 dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2019. Me vendim nr. 15, datë 09.01.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor emërohet gjyqtar. Me vendim nr. 55, datë 29.01.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor caktohet në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, ku dhe aktualisht ushtron detyrën. Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 2 vite.

Nuk ndodhet në një pozicion me mandat të kufizuar. Nuk është dhe as ka qenë më parë i komanduar dhe nuk ka masë disiplinore në fuqi.

12. **Në këto kushte, për këtë gjyqtar, nuk ekziston asnjë kriter ndalues komandimi.**

ii. Në lidhje me cenimin apo dëmtimin e funksionalitetit (interesit të lartë) të gjykatës

13. **Sa i përket cenimin apo dëmtimin e funksionalitetit (interesit të lartë) të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin, nga raportimet periodike dhe informacioni e mendimi i marrë nga kryetarja e gjykatës respektive, rezulton se:**
14. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës ka në organikën e saj 4 (katër) gjyqtarë dhe në detyrë janë 4 (katër) të tillë, por një nga ata është i transferuar përkohësisht në këtë gjykatë, z. {…}, gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë.
15. Nga verifikimi i kryer nga ana e specialistit të IT-së në sistemin e menaxhimit të çështjeve gjyqësore ICMIC i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, rezulton se ngarkesa e çështjeve në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës më datë 08.11.2022 është si vijon:

	Në gjykim	Të gjykuara 2022
{…}	93	326
{…}	136	334
{…}	63	9
{…}	230	243
Totali si gjykate	522	912

16. Sipas opinionit të zëvendëskryetares së gjykatës së rrethit gjyqësor Kukës, rezulton se: "*Në lidhje më sa më sipër, ju informojmë se z. {...} me vendimin Nr.55, datë 29.01.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor "Për caktimin në pozicion të gjyqtarit të emëruar z. {...}", është caktuar për të ushtruar funksionin e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës dhe ka mbi 2 (vjet) që e ushtron këtë funksion.*
... Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës, në vijimësi ka paraqitur nevojë për caktim gjyqtari në çështje gjyqësore të veçanta.
17. *Gjatë kësaj periudhe kur gjyqtari {...} ka ushtruar funksionin si gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, ai ka gjykuar si çështje penale ashtu edhe çështje civile. Kjo për faktin se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës për shkak të numrit të vogël të gjyqtarëve që ka në organikën e saj (4 gjyqtarë) e ka të pamundur që zhvillimin e veprimtarisë gjyqësore t'a kryejë me ndarje në seksione të veçanta. Pra, të gjithë gjyqtarët pjesë e organikës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës marrin pjesë në shortimin elektronik të çështjeve gjyqësore duke marrë për gjykim si çështje civile ashtu edhe çështje penale.*

18. *Përgjatë këtyre viteve që ka ushtruar detyrën në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës, vlerësoj se z. {...} ka treguar profesionalizëm dhe përkushtim në dhënien e drejtësisë. Në supozimin e komandimit pranë Ministrisë së Drejtësisë të këtij gjyqtari, në pikëpamje të ngarkesës së punës dhe funksionalitetit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor*

Kukës, këtë e lemë në vlerësimin tuaj!"

19. Nga informacioni i marrë pranë Departamentit të Shërbimeve Juridike rezulton se për vitin 2022, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës ka paraqitur në total **7** kërkesa për caktim gjyqtari, në përgjigje të të cilave janë caktuar **7** gjyqtarë për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të ndryshme, nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyre të përhershme.

20. Në kushtet e mësipërme, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës vlerëson se komandimi i z. {…}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit gjyqësor Kukës në pozicionin "Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit" në Ministrinë e Drejtësisë, përballë ngarkesës së çështjeve që ka kjo gjykatë dhe numrit aktual të gjyqtarëve që ushtrojnë efektivisht detyrën pranë kësaj gjykate, sikundër dhe pritshmërisë pozitive që do të sjellë zbatimi i hartës së re gjyqësore, nuk passjell cenim të interesave të larta të kësaj gjykate për sa kohë funksionaliteti i saj do të vijojë të ruhet.

21. Mbi sa më lart, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor që të vendosë:

21.1 T'i dërgohet Ministrisë së Drejtësisë emri i z. {…}, i cili ka aplikuar për t'u komanduar, në pozicionin "Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit" në Ministrinë e Drejtësisë, si dhe praktikën dokumentare të paraqitur prej tij.

21.2 Publikimin e këtij opinioni në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

KOMISIONI I ZHVILLIMIT TË KARRIERËS